



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.390/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj, anëtarë, me zyrtarin e lartë ligjor Kudret Hasani, duke vendosur lidhur me apelin e parashtruar nga subjekti politik Gi Srpska Lista me seli në Komunën e Graçanicës, kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë, lidhur me publikimin e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të datës 11.06.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik Gi Srpska Lista, me seli në Komunën e Graçanicës, e parashtruar kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të 1,200.00 votave me kusht, me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve parlamentare të datës 11.06.2017.

Arsyetim

Parashtruesi i apelit nga subjekti politik Gi Srpska Lista, 30.06.2017, ka paraqitur një apel në PZAP, kundër vendimit të KQZ-së, për shkak të mos përfshirje së 1200 votave me kusht, në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve të cilët votues pretendohet se kanë qenë nga Komunitatet Leposaviq 591 vota, Mitrovica Veriore 394 vota, Zveçan 215 vota dhe Zubin Potok 92 vota. Sipas parashtruesit të ankesës vota ka qenë rregullta duke bazuar në doracakun për shërbim të votuesve sepse votuesit kanë qenë të pajisur me dokumente valide dhe të cilat dokumente janë përdorur vetëm për identifikim të votuesve në vendvotime por nuk mund të jenë bazë për fitimin e të drejtës në votë. Më tej parashtruesi i apelit thekson se me rastin e regjistrimit të këtyre votave në QNR, të gjitha këto janë anuluar pasi që është vërtetuar se të gjithë votuesit me kusht kanë qenë të pajisur me dokumente valide të “MUP të Republikës së Serbisë” në këtë mënyrë konsideron se këtyre votuesve ju është cenuar e drejta themelore të përcaktuar me ligj pasi që nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë me votuesit tjerë të rregullt të cilët po ashtu ju është dhënë mundësia për të votuar me dokumente valide të “MUP të Republikës së Serbisë”.

Me propozim për PZAP-in, që ankesa të pranohet dhe të gjithë votuesve me kusht të vërtetohet se janë në listën e votuesve dhe te detyrohet KQZ-ja, të përfshi edhe këto vota në rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përgjigje në apel thekson se te gjitha pretendimet ankimore në apel ndërlidhen me procedimin dhe administrimin ne QNR, i cili proces i administrimit ka përfunduar me datë 24.06.2017 ora 15:00, ndërsa ankesa ne PZAP është parashtruar me datë 30.06.2017, me propozim që ankesa të hudhet si e pasafatshme ne kuptim te nenit 105 te LZP-së.

Paneli pasi që shqyrtoi dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Apeli është i pabazuar

Paneli konsideron se votimi me kusht dallon nga votimi i rregullt, pasi që votuesit me kusht edhe po mos te ishin në Librin Përfundimtar të Votuesve (LPV), mund të votojnë por duhet të posedojnë dokument identifikimi të pranueshëm. Ky dokument i pranueshëm, paraqet dokumentin i cili është lëshuar nga organet kompetente te Republikës së Kosovës – Ministria e Punëve të Brendshme. Në rastin konkret parashtruesi i ankesës pretendimet e tij nuk i ka provuar me prova me te cilat do të dëshmonin se votuesit në fjalë kanë poseduar dokumente valide me rastin e votimit siç përcaktohet me nenet 5,6 dhe 9 të LZP-së.

Sa i përket pretendimeve tjera të theksuara në ankesë është vlerësuar se janë pa ndikim për të vendosur ndryshe, në këtë rast konkret.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e neneve 117 par.2 118 par.1 të LZP-së, si dhe nenit 11 par.6 të Rregullës Nr.02/15 të PZAP-it, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 390/2017 më datën 02.07.2017.



Kryesuesi i Panelit
Ymer Hoxha

Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.